REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KËSHILLI I MINISTRAVE**
**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

# VENDIM

Nr.19, datë 24.04.2024

## PËR MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "SHTESË E IMPIANTIT TË PËRPUNIMIT TË UJIT NË BOVILLË ME 1800 1/SEK, NË FAZËN E DYTË TË ZBATIMIT PËR 1200 1/SEK", ME VENDNDODHJE NË BASHKINË KAMËZ DHE BASHKINË TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 40, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Tiranë" sh.a., Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të Lejes së Ndërtimit të objektit: "Shtesë e impiantit të përpunimit të ujit në bovillë me 1800 1/sek, në fazën e dytë të zbatimit për 1200 1/sek", me vendndodhje në Bashkinë Kamëz dhe Bashkinë Tiranë, të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.5, datë 26.01.2021.

2. Afati i kryerjes së punimeve sipas këtij Vendimi, do të pasqyrohet në Dokumentin e Lejes së Ndërtimit, në përputhje me afatin e përcaktuar në grafikun e punimeve.

3. Harta e Planvendosjes së Strukturave miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.5, datë 26.01.2021, nuk ndryshon.

4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**

MINISTËR I LINJËS

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

**BELINDA BALLUKU**

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**ADELAJDA ROKA**

Nënshkruar më datë 24 /05/ 2024